

FUQIA E FJALËS DHE SI (MOS)KUPTIMI I DREJTË I FJALËS NDIKON NË PERCEPTIMIN MBI PROFESIONIN QË LIDHET ME TË

nga Zydi Teqja

“Peizazhi nuk është një tipar natyror i mjedisit” J. Jackson, 1984

Përpara pak kohësh arrita të publikoj librin tim “Bazat e arkitekturës së peizazhit”, rezultat i një pune të gjatë studimore dhe kërkimore. Ndërkohë që po ndiqja procedurat e katalogimit të librit në bibliotekën kombëtare mësova që libri im duhej futur në kategorinë “Zbukurimi i mjedisit”. Ndërkohë më ka ndodhur jo rrallë që, kur më pyesin se çfarë pune bëj dhe u them që merrem me arkitekturën e peizazhit, bashkëbiseduesit shprehin: “Ah pejsazhi, sa bukur, lum si ju; ju e kaloni kohën me lule, gjelbërim, me kopshte, parqe e me gjëra të bukura”. Dhe në fakt edhe klientët shpesh kërkojnë që të kenë atë peizazhin me pemë me gjelbërim të përhershëm, me lule të cilat nuk vyshken kurrë dhe me tapet bari. Për habinë e bashkëbiseduesve të mi, kjo nuk më bën që të ndihem mirë, për të mos thënë që ndihem keq, sepse janë pikërisht këto këndvështrime shkak i shumë problemeve të botës sot.

Pasi bëra disa përpjekje për ta ndarë shqetësimin me disa ekspertë të fushës së gjuhësisë vendosa ta ndaj shqetësimin tim me një komunitet më të gjerë lexuesish dhe natyrshëm mendova: ku ka më mirë se sa në një revistë që fjalën peizazh e ka në titullin e saj.

Kur diskutojmë për kuptimin e fjalëve të futura në shqip nga gjuhë të tjera është e natyrshme që të shikojmë kuptimin e fjalës në origjinën e saj.

ETIMIOLOGJIA DHE HISTORIA E PËRDORIMIT TË FJALËS PEIZAZH NË GJUHËT ANGLO- SANKSONE DHE LATINE

Ndonëse ekzistojnë përshkrime të peizazhit edhe në pikturat e lashtësisë, nocioni i peizazhit raportohet të jetë përdorur fillimisht në shekujt 4 dhe 5, së pari në Lindjen e Largët si art i pikturës dhe pastaj edhe në Europën Veri-perëndimore dhe Britaninë e Madhe si “landskift”, “landscape”, “landschaft” ose “landscaef” për t’ju referuar një sistemi hapësirash të kthyer nga njeriu në hapësira të përdorshme toke si parcela të kufizuara por jo domosdoshmërisht me gardhe apo mure (Motloch, 2001; Murphy, 2016). Pra në periudhën e parë të përdorimit të fjalës në Europë, peizazhi i referohej një njësie të vogël administrative, njësie natyrale, një rajoni apo zone toke siç mund të jetë një luginë lumi, disa kodra që ishin zënë nga një fis apo më vonë nga një feudal.

Si variacionet e anglishtes së vjetër, ashtu edhe fjalët përkatëse në gjermanisht, në hollandisht, danisht e suedisht vijnë nga të njejtat rrënjë, por jo gjithmonë përdoren në një kuptim plotësisht të njejtë. Kështu landschafti gjerman, për shembull, mund të jetë një njësi e vogël administrative, që i korrespondon për nga madhësia, lagjes tonë në zonat rurale. Po kështu ka ndryshime të vogla midis mënyrës se si amerikanët e përdorin fjalën dhe mënyrës se si e përdorin anglezët. Për amerikanët peizazhi ka një theks në elementët natyrorë, ndërsa në Angli peizazhi pothuajse gjithmonë përmban një element njerëzor.

Studiuesi i peizazhit John. B. Jackson (1909-1996) ishte njohës i mirë i gjuhëve frënge (kishte lindur në Francë), gjermane (jetoj në Zvicër e Gjermani në rininë e tij) dhe angleze (ndoqi Universitetin e Harvardit në fillim të viteve 1930’, ishte themelues i revistës “Landscape” në vitin 1951, dhe profesor i Universitetit të Kalifornisë, Berkeley). Në artikullin e tij “The word itself” (1984), Jackson trajton etimologjinë e fjalës “peizazh” duke gjurmuar përdorimin e saj në gjuhët Europiane dhe përdorimin në traditat bujqësore, në ndarjet administrative, në pikturë dhe në teatër.

Pjesa e parë e fjalës, “land” në gjuhët gjermanike dhe “pays” në gjuhët latine, në Mesjetë, nënkuptonte tokën dhe dheun, si dhe një pjesë të sipërfaqes së planetit. Por një kuptim shumë më i hershëm gotik ishte “fushë e lëruar”. Fjalori monumental i gjuhës gjermane i Grimm thotë se “Land” fillimisht nënkuptonte parcelën e tokës ose brazdat në një fushë, ku çdo vit zbatohej qarkullimi bujqësor ose rishpërndarja e bimëve të kultivuara. Studiuesit mendojnë që në periudhën e Mesjetës përdorimi më i zakonshëm i fjalës peizazh tregonte një pjesë të mirëpërcaktuar të sipërfaqes së tokës. Një parcelë e vogël ferme ishte një tokë (land), apo edhe një territor sovran (Psh England, Scotland, Deutschland ose shtetet përbërëse të federatës gjermane apo austriake; Landi i Bavarisë, i Bremenit etj); çdo zonë me kufij dhe përkatësi të njohur ishte një “Land”.

Në gjuhët latine pjesa e parë e fjalës vjen nga latinishtja “pagus”, një term që do të thotë “kanton rural”. Kështu, Pagus mund të përkthehet si “vend i vogël i kufizuar”.

Tani, të vijmë në pjesën e dytë të fjalës: “scape” në gjuhët gjermanike dhe “age” në frengjisht dhe gjuhët e tjera latine. Kuptimi në thelb është i njëjtë me fjalën shape=formë, por dikur nënkuptonte një përbërje objektesh të ngjashme, ashtu si kur flasim për një shoqëri ose për anëtarësinë e një shoqate. Anglishtja e vjetër, ose anglo-saksone, duket se përmban disa fjalë të përbëra që përdorin pjesën e dytë -scape ose ekuivalentin e saj - për të treguar aspekte kolektive të mjedisit. Kjo të bën të mendosh që fjala “Scape”, në periudhën e Mesjetës, tregonte gjithashtu diçka si një organizim ose si një sistem. Në gjuhët latine prapashtesa -age pas një foljeje tregon një veprim, pas emrit të një personi, një gjendje dhe pas emrit të një sendi të pajetë, një koleksion. Kuptimi si “koleksion” pajtohet me kuptimin që i jepet aktualisht “peizazhit” si një ansambël objektesh të një vendi ose një ansambël vendesh.

Prandaj, termi peizazh i referohet jo vetëm vendit, por edhe shoqërisë që e menaxhon atë dhe mënyrës së qeverisjes territoriale që ushtron kolektivisht mikroshoqëria që jeton në këto terrene. Ky kuptim vërtetohet nga termi gjerman landschaft; “land” që është vendi dhe “schaft”, shoqëria.

Rrjedhimisht, në fillimet e tij termi “peizazh” si në gjuhët anglo-saksone ashtu edhe latine, duhet të ketë nënkuptuar diçka si një kompleks ose një sistem hapësirash të fermave rurale. Në çdo rast, është e qartë se një mijë vjet më parë, fjala nuk kishte të bënte fare me aspekte estetike apo skenike ose me përshkrimin e tyre.

Pra, përdorimi i parë i fjalës peizazh kishte kuptimin e një territori të kufizuar i cili ishte transformuar në një shkallë të caktuar nga njeriu për qëllime përdorimi si vendbanim apo për aktivitet ekonomik.

Përpara se të bëhej objekt paraqitjesh apo studimesh artistike, peizazhi ishte një vend me një identitet të qartë, që do të thotë një pjesë e territorit që ofron perspektiva pak a shumë të rëndësishme, vend jetese dhe pune për banorët vendas që janë pjesë e këtij vendi.

Por duket se termi peizazh në gjuhët origjinale latine, në krahasim me gjuhët anglo-saksone, nënkupton më shumë pamjen e një piktore sesa idenë e planifikimit hapësinor. Si i tillë ai luan një rol thelbësor në vlerësimin e territoreve, veçanërisht nga fuqitë politike që shohin aty një mjet për të përfaqësuar hapësirën në të cilën mbretërojnë dhe për rrjedhojë imazhin e tyre përballë shoqërisë që ata qeverisin.

Sipas Kenneth Clark (1949) arti i Mesjetës karakterizohet nga mbizotërimi i simbolikës mbi ndjesitë shqisore dhe simbolet e objekteve natyrore kishin pak lidhje me pamjen reale të tyre. Kjo gjë rrjedh nga filozofia kristiane e asaj periudhe, sipas të cilës jeta tokësore konsiderohej një tranzicion i shkurtër dhe si rrjedhojë detajet e kësaj bote nuk duhet të merrnin shumë vëmendje. Kështu në përgjithësi arti i Mesjetës karakterizohet nga mungesa e besimit për natyrën dhe ky qëndrim ndaj natyrës nuk mund të prodhonte pikturën e peizazhit në kuptimin

tonë modern, por përgatiti rrugën për llojin e artit që është quajtur peizazhi i simboleve (Clark, 1949).

Objektet natyrore fillimisht perceptoheshin individualisht. Hapi tjetër drejt pikturës së peizazhit ishte t'i shihje ato si një tërësi dhe si simbol i përsosmërisë. Afresket në pallatin e Papëve në Avignon (shekulli i XIV-të) janë nga shembujt e parë të plotë të peizazhit të simboleve, si në temë ashtu edhe në stil. Ato tregojnë njerëz duke peshkuar në një pishinë kopshti, duke luajtur me zogj dhe kafshë të tjera dhe duke shijuar jetën jashtë.

Në shekullin e 15-të, ishte krijuar një kuptim i ri i njerëzimit mbi fenë i cili bëri të mundur që ekzistenca tokësore të konsiderohej e denjë për t'u përshkruar dhe kështu ngjarjet e shenjta u lidhën me aspekte të jetës së përditshme. Në këtë kohë, piktorët e peizazhit gjetën një lloj të ri lirie duke përfshirë në pikturë pamjen që ishte përtej dritares. Forma e sotme e fjalës me konotacionin e saj skenik shfaqet pikërisht në këtë kohë kur termi "landschap" u fut nga piktorët danezë për t'ju referuar pikturave të natyrës tokësore apo skenave rurale dhe pastaj gjatë shekullit të 16-të përhapet thuajse në të gjithë Europën Perëndimore. Ky kuptim i fjalës "Landscape"- peizazh, për herë të parë në Britani haset në vitin 1598 (Motloch 2001). Në këtë kohë, artistët danezë dhe të vendeve të tjera si Belgjika e Holanda dhe Italia, ishin bërë mjeshtrë në gjininë e artit të peizazhit.

Peizazhet e para u shfaqën zakonisht nëpërmjet një dritareje që ishte pjesë e në një pikturë më të madhe. Duhet nënvizuar që në këtë dritare piktorët nuk shfaqnin realitetin, por një lloj pamje të idealizuar se si mund të dukej realiteti. Deri në fillim të shekullit të 16-të, piktura e peizazhit dominohej ende nga hapësira simbolike e parë nga një këndvështrim i ngritur dhe qëllimi kryesor ishte që të përshkruhen skena nga Bibla dhe jeta e shenjtorëve. Më vonë piktura filloi të kishte elementë të shumtë të gjallë nga bota reale. Peizazhet e thjeshta, të jetës reale filluan të shfaqen vetëm rreth mesit të shekullit të 16-të. Në fillim të shekullit të 17-të, kjo qasje e re ndaj peizazhit u zhvillua më tej me përjetime subjektive.

Rilindja europiane nxjerr në pah një konceptim të ri të peizazhit dhe të botës, duke sjellë një vizion utopik të mjedisit jetësor të ngjashëm me parajsën. Ky konceptim i ri u përforcua fuqishëm nga piktura, e cila në këtë kohë fillon të distancohet nga përfaqësimi ekskluziv fetar i peizazheve. Kjo u realizua nëpërmjet trajtimit artistik të vendit duke e sjellë spektaklin e natyrës si një objekt soditjeje, i cili i humbet atributet fetare. Kështu artistët e Rilindjes europiane duke e pikturuar natyrën e modifikojnë atë me qëllim që ta bëjnë më të bukur. Megjithatë, në kuptimin e piktorëve fjala peizazh, deri në shekujt XVIII-të dhe XIX-të, më shumë sesa realitetit i referohej një imazhi hipotetik. Ky imazh shpesh vinte nga përshkrimet biblike dhe historike. Pikturat realizoheshin në studio dhe rrallë piktorët dilnin në natyrë, sa për të skicuar ndonjë element peizazhi apo për të marrë ndonjë ide e cila do të zhvillohej më vonë në studio.

Kështu lindi përdorimi i dytë i fjalës peizazh për të folur për një zhanër të ri në pikturë. Në këtë kohë në kopshte mbizotëronte stili formal që promovonte kontrollin e njeriut mbi natyrën. Projektimi i kopshteve dhe piktura ishin larg njëra tjetrës.

Kuptimi i fjalës peizazh si një gjini e pikturës, është më i theksuar në gjuhët latine ose në ato gjuhë të cilat e huazuan fjalën nga këto të fundit. Këtu përfshihet edhe gjuha shqipe, turqishtja dhe shumica e gjuhëve sllave.

Nga sa u trajtua më sipër, del që peizazhi nuk është një tipar i pastër natyror i mjedisit, por një hapësirë e krijuar nga njeriu, një sistem i hapësirave të vendosura në faqen e tokës, që funksionon dhe zhvillohet jo sipas ligjeve natyrore, por për t'i shërbyer një komuniteti (Jackson, 1984). Peizazhi është kështu një hapësirë e krijuar qëllimisht për të përshpejtuar ose ngadalësuar proceset natyrore. Ai nënkupton që njeriu ka marrë mbi vete rolin e kohës. Sfidat

në këtë rast është që këto organizime artificiale të hapësirave të asimilohen sa më mirë në mjedisin natyror, në mënyrë që të funksionojnë në harmoni me natyrën dhe ndërhyrjet mundësisht të mos duken si krijime artificiale. Nuk është rastësi që pjesa më e madhe e krijimit të këtij lloj peizazhi u zhvillua gjatë një periudhe kur po projektoheshin kopshtet dhe parqet më të mëdha dhe komplekset më madhështore të qyteteve.

Deri në shekullin e XVIII-të, peizazhi vlerësohej duke iu referuar modeleve estetike nga Antikiteti dhe Bibla. Fundi i shekullit të XVIII-të është momenti vendimtar i një ndryshimi të thellë të të menduarit mbi peizazhin që lidhet edhe me ndryshimet sociale dhe politike, si kriza e sistemit politik feudal, që i hapi rrugën demokracisë; revolucionet demokratike në Francë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kthimi i Anglisë në një monarki parlamentare ku mbreti nuk ka më të njëjtin pushtet.

Në shekujt XVIII-të dhe XIX-të fjala peizazh ndryshoi gradualisht në kuptim. Në këtë kohë, kemi një zhvendosje nga piktura e një pamjeje tek vetë pamja. Piktoret filluan që gjithnjë e më shumë të dalin në terren dhe të zbulojnë pamje të bukura, bazuar mbi kriteret e bukurisë së peizazhit të përcaktuara nga kritikët dhe artistët. Ky zhvillim e transformoi edhe projektimin e kopshteve dhe të parqeve pasi projektuesit hoqën dorë nga format perfekte gjeometrike dhe kaluan në forma natyralistike, në mënyrë që kopshtet dhe parqet të ngjanin me peizazhin baritor. Kështu lindi kopshtaria peizazhistike. Ashtu si piktori përdorte gjykimin e tij se çfarë të përfshinte ose të hiqte në kompozim, projektuesi i kopshtit peizazhistik (siç njihej në shekullin e XVIII-të) u përpoq të krijonte një peizazh të stilizuar “piktorek”, duke lënë jashtë rrugët me baltë, fshatrat e varfër dhe në përgjithësi pamjen e vërtetë dhe duke përfshirë disa veçori të këndshme natyrore: përrenj dhe korije me pemë dhe hapësira të sheshta me bar. Rezultatet shpesh ishin jashtëzakonisht të bukura, por ato gjithësesi ishin përsëri piktura ose fotografi, megjithëse kjo tashmë ishte një fotografi tredimensionale.

Një tjetër përdorim i termit peizazh është ai në dramaturgji. Sipas J. Jackson (1984) nuk ka tregues më të mirë se si mund të përshkruhet ndryshimi i marrëdhënies tonë me mjedisin gjatë shekujve sesa evolucioni i rolit të peizazhit skenik. Deri në shekullin e XVII-të, dramata zakonisht kishin një përdorim të thjeshtë të rrethanave ku zhvillohen ngjarjet, të formës “Ngjarjet zhvillohen në pallatin mbretëror”. Në shekullin e XVIII-të, peizazhi në skenë kishte funksionin të sugjeronte në mënyrë diskrete vendndodhjen e veprimtimit ose edhe kohën e ditës kur zhvilloheshin ngjarjet. Në ditët e sotme, dramaturgët modernë jo vetëm që japin përshkrime të detajuara të skenave njëra pas tjetrës, por në spektaklet e thjeshta televizive apo në filmat bashkëkohorë, teknologjia digjitale lejon mundësinë e shumëllojshmërisë së skenave me një nivel të lartë realizmi. Këtu skena bën shumë më tepër sesa thjesht të identifikojë kohën dhe vendin dhe të vendosë atmosferën. Ajo bëhet një element aktiv i shfaqjes.

Mbështetja në këndvështrimin artistik dhe në përkufizimin artistik për bukurinë e peizazhit vazhdoi gjatë gjithë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Themeluesi i profesionit të arkitektit të peizazhit, Frederick Law Olmsted dhe ndjekësit e tij i projektuan parqet dhe kopshtet e tyre peizazhistikë duke ndjekur kritere “piktorek”. Por ndryshe nga piktura, një dizajn i tillë përmban një sërë kompozimesh piktorek. Në secilin prej tyre ne mund të gjejmë parimet themelore të njohura të unitetit, të përsëritjes, të ekuilibrit, të harmonisë dhe kontrastit. Shekujt XVIII-të dhe XIX-të shënojnë ndoshta periudhën kur piktura ishte më afër projektimit të peizazhit.

Në shekullin e XX-të ndodhën një sërë zhvillimesh në shkencë dhe shoqëri të cilat e ndryshuan këtë marrëdhënie. Sipas Kenneth Clark, në librin e tij “Peizazhi në Art” (1949): “Mikroskopi dhe teleskopi e kanë zgjeruar kaq shumë gamën e shikimit tonë, sa që natyra e rehatshme dhe e ndjeshme që ne mund ta shohim me sytë tanë ka pushuar së kënaquri

imagjinatën tonë.” Për rrjedhojë, në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të dizajni i peizazhit dhe piktura ecën në rrugë të ndryshme. Njohuritë për ekologjinë dhe ruajtjen e mjedisit u bënë pjesë e sfondit profesional të arkitektëve të peizazhit, dhe mbrojtja e menaxhimi i peizazhit filluan të shihen si më të rëndësishëm se projektimi i parqeve piktoreske. Kështu, arkitektët e peizazhit nuk u drejtohen më piktorëve për frymëzim, kurse piktorët duket se e humbasin disi interesin për të prodhuar peizazhe konvencionale (Jackson, 1984). Dy disiplinat arkitektura e peizazhit dhe piktura e peizazhit e humbën monopolin mbi fjalën peizazh dhe ajo, që nga fundi shekullit të kaluar, është përfshirë në fokusin e shkencave të mjedisit si dhe është bërë pjesë e sferës publike.

Tani fjala peizazh përdoret me shumë më tepër liri, shpesh pa u shqetësuar shumë për kuptimin e saj të drejtpërdrejtë; Në ditët e sotme ne hasim shprehje si peizazhi politik, apo edhe përdorime të tjera metaforike si “peizazhet e imazheve të një poeti”, “peizazhi i ëndrrave”, “peizazhi i mendimit”, ose “peizazhe të fjalës”, apo, në një nivel krejt tjetër, “peizazhi politik i Konferencës së NATO-s” etj. Këto përdorime janë të largëta por megjithatë, ata evidentojnë një të vërtetë të rëndësishme: se ne gjithmonë kemi nevojë për një fjalë ose frazë për të treguar një lloj mjedisi ose rrethanash që mund t’i japin gjallëri një mendimi, ngjarjeje ose marrëdhënieje; një sfond që e vendos atë në botë. Ky është një kuptim tjetër për peizazhin që ngjan me përdorimet metaforike të fjalëve klimë ose atmosferë. Në fakt, peizazhi kur përdoret si term piktori shpesh nënkupton “të gjithë atë pjesë të një pamje që nuk është e trupit apo argumentit” si retë në një skenë beteje ose pamja e kodrave dhe e pyllit në një skenë gjuetie. Po kështu teknikat skenike dhe peizazhet teatrore janë imitime të rrethanave reale ku zhvillohen ngjarjet e pjesës teatrale.

Sipas J. Jackson, ndërkohë që mendimet tona bëhen komplekse dhe abstrakte, ne kemi nevojë për metafora për t’u dhënë atyre një shkallë realiteti. Askush nuk e mohon se ndërsa bëhemi të pasigurtë për statusin tonë, kemi nevojë për të patur gjithnjë e më shumë përforsime nga mjedisi ynë. Ai thekson se “nëse *sfond* duket një fjalë modeste por jo e papërshtatshme, duhet të kujtojmë se në përdorimin tonë modern të fjalës, sfond nënkupton atë që nënvizon jo vetëm identitetin dhe praninë tonë, por edhe historinë tonë.” Por - sugjeron J. Jackson - ne nuk duhet ta përdorim fjalën peizazh për të përshkruar botën tonë private, sepse peizazhi është një realitet konkret, tredimensional dhe i përbashkët.

PËRKUFIZIMI I PEIZAZHIT DHE KARKATERI I TIJ SHUMËDIMENSIONAL

Një nga përkufizimet më të hershme të peizazhit na vjen nga shekulli i XVII-të dhe është ai i Antoine Furetière (1690), i cili, në Fjalorin e tij Universal të gjuhës frenge, botuar në vitin 1690 në Holandë, propozon dy kuptime për “peizazhin”:

PAISAGE- Pamja e një vendi, territori, që shtrihet aq sa mund të shohë syri. Pyjet, kodrat dhe lumenjtë krijojnë peizazhe të bukura.

PAISAGE- pikturat që paraqesin pamje shtëpish ose fshatrash.

Pak a shumë kështu ka mbetur përkufizimi i peizazhit në fjalorët standard të shumë gjuhëve të botës, duke mos pasqyruar siç duhet zhvillimet në disiplina të ndryshme shkencore apo shoqërore. Koncepti popullor i peizazhit që gjendet edhe në fjalorët e sotëm ndjek një kuptim të veçantë dhe një të përgjithshëm; të veçantë pasi i referohet një zone të sipërfaqes së tokës dhe një kuptim të përgjithshëm pasi kuptohet se është çfarë mund të shihet nga një vëzhgues.

Në shekullin e XVIII-të dhe XIX-të si rezultat edhe i ndikimit të rrymave artistike si romanticizmi dhe surrealismi të cilat vlerësojnë imagjinatën dhe emocionet njerëzore, peizazhi mori edhe një karakter të rëndësishëm si një gjendje e caktuar shpirtërore. Për të kuptuar këtë aspekt të peizazhit përfytyroni psh., një pamje romantike të Thethit me Alpet në sfond, apo momentin e perendimit të diellit në bregdetin tonë. Shpesh këto janë momente

unike që nuk përsëriten sepse kurrë nuk do t'i arrini më ato kushte të dritës, të ngjyrave apo edhe të gjendjes tuaj shpirtërore.

Që nga fundi i shekullit të XIX-të dhe fillimi i shekullit të XX-të peizazhi u bë një fushë e rëndësishme studimi e gjeografëve. Gjatë viteve 1920' dhe 1930' u bënë përpjekje për të ndërtuar metodologji që e bënin peizazhin detyrë kryesore, në mos ekskluzive të gjeografisë. Kjo u mbështet nga pikëpamja e Sauer sipas të cilës roli i gjeografisë është të vlerësojë sistematikisht “fenomenologjinë e peizazhit”. Kështu gjeografia e vendosi peizazhin ndër konceptet e saj kryesore, duke e konsideruar atë si produkt të marrëdhënies midis natyrës dhe veprimtarive njerëzore. Carl Sauer, në botimin e tij “The Morphology of Landscape” (1925) e përkufizon peizazhin si “një formë toke, në të cilën procesi i formësimit nuk konsiderohet si thjesht fizik por peizazhi përkufizohet si një zonë e përbërë nga një lidhje e veçantë e formave, si fizike ashtu edhe kulturore.”

Duke bërë një analizë të gjatë të termit peizazh, Richard Hartshorne (1939), e përcaktoi peizazhin si “sipërfaqja e jashtme e tokës, që shikohet (ose preket). Kjo sipërfaqe formohet nga sipërfaqet e jashtme që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me atmosferën; vegetacioni, toka e zhveshur, bora, akulli, trupat ujorë apo tipare të ndërtuara nga njeriu”. Richard Hartshorne e ndau këtë term nga termi rajon dhe nuk përfshiu perceptimin e peizazhit me anë të shqisave të tjera veç shikimit, psh. tingujt, aromat etj.,. Sipas tij këto nuk kontribuojnë për një koncept të unifikuar.

Lidhur me konceptin e peizazheve natyrale dhe historike të cilin veç të tjerëve e diferencoi Carl Sauer, ai thotë “peizazhi natyror pushoi së ekzistuari kur në skenë doli njeriu”. Sipas tij koncepti i peizazhit natyral është një koncept teorik, pasi ky peizazh, kurrë nuk ka ekzistuar. Në vitet 1940' koncepti i peizazhit natyral u vu gjithnjë e më shumë në pikëpyetje me rritjen e njohurive për ndikimin human në mjedis.

Peizazhi mbeti një koncept thelbësor i gjeografisë deri rreth viteve 1950-të. Në këtë kohë, nga njëra anë ju dha më shumë rëndësi proceseve natyrore dhe gjeografisë fizike dhe nga ana tjetër fillimi i shfaqjes së problemeve mjedisore bënë që koncepti i peizazhit të përparonte duke e vendosur atë krahas koncepteve të gjeosistemit dhe territorit si një nga konceptet thelbësore për të kuptuar ndërveprimet midis qasjes së natyralizuar politike dhe simbolike ndaj hapësirës gjeografike. Publikimi i veprës së Ian McHarg “Projektim me natyrën” në fund të viteve 1960' e zgjeroi kuptimin për peizazhin dhe shënon vendosjen e bazave shkencore të arkitekturës së peizazhit (McHarg, 1992).

Meinig, në vitet 1970', shtoi aspektet psikologjike në interpretimin e peizazhit. Peizazhi është “i përbërë jo vetëm nga ajo që qëndron para syve tanë, por edhe nga ajo që ndodhet brenda kokës tonë”. Kështu, peizazhi është një entitet që përcaktohet nga shqisat tona dhe interpretohet nga intelektin ynë. Ai pasqyron përvojën e mëparshme, si dhe vlerat mbizotëruese kulturore, sociale dhe ekonomike. Peizazhet shprehin, përveç përbërjes së tyre biofizike, karakterin e një shoqërie; si ka evoluar ajo gjatë një periudhe të gjatë kohore. Një kuptim më i plotë i peizazhit mund të arrihet duke marrë parasysh jo vetëm gjendjen e tij fizike dhe reagimin emocional ndaj perceptimit tonë mbi të, por edhe duke njohur pasqyrimet në peizazh të vetë shoqërisë, të vlerave, të teknologjisë dhe të aspiratave të saj.

John Jackson, në vitin 1984, në veprën e tij “Discovering the Vernacular Landscape”, bazuar në përkufizimet e shumta dhe në një farë konfuzioni mbi termin, shtron nevojën për të formuluar një përkufizim të ri të peizazhit i cili të adresojë një përbërje të hapësirave të krijuara ose të modifikuara nga njeriu për të shërbyer si infrastrukturë ose sfond për ekzistencën tonë kolektive. Lidhur me këtë këndvështrim ai thotë:

“Peizazhi nuk është një tipar natyror i mjedisit, por një hapësirë sintetike, një sistem i

krijuar nga njeriu i hapësirave të mbivendosura në faqen e tokës, që funksionon dhe zhvillohet jo sipas ligjeve natyrore, por për t'i shërbyer një komuniteti.”

Jackson argumentoi rëndësinë e kuptimit të peizazhit si një “realitet konkret, tredimensional dhe i përbashkët”. Megjithatë, ai vazhdoi t'i qëndroi besnik përkufizimit “të modës së vjetër”, të cilin e gjejmë që me Antoine Furetière (1690), të peizazhit si: “Një pjesë e sipërfaqes së tokës që mund të kapet dhe të kuptohet me një shikim”.

Në dekadat e fundit të shekullit të XX-të, me theksimin më të madh të perceptimit mjedisor, peizazhi shikohet si lëndë e parë për të studiuar perceptimet njerëzore dhe procesin informues tek njeriu. Kështu Cosgrove dhe Daniels (1989) e kanë përcaktuar peizazhin jo në terma fizikë, por si shprehje e jashtme e perceptimit njerëzor: “Peizazhi është një imazh kulturor, një mënyrë piktoreske për të paraqitur, strukturuar ose simbolizuar çfarë është rreth nesh. Peizazhi konsiderohet “mjedis i perceptuar”.

Kështu vijmë në fillimin e shekullit të XXI-të kur Konventa europiane e peizazheve (Firence 20 Tetor 2000) miraton këtë përkufizim për peizazhin:

Termi “Peizazh” përcakton një pjesë territori ashtu siç perceptohet prej njerëzve, karakteri i të cilit varet nga veprimi dhe bashkëveprimi i faktorëve natyrorë dhe/apo njerëzorë.

Sipas këtij përkufizimi koncepti i peizazhit duhet aplikuar në të gjitha pjesët e territorit; natyrale, rurale, urbane e periurbane. Prandaj, edhe arkitektura e peizazhit angazhohet kudo ku ka nevojë për ndërhyrje me qëllim përmirësimin e situatës; në zonat rurale, në qytete, në fushat bujqësore dhe në zonat e degraduara, Ajo merret edhe me historinë e peizazhit me qëllim njohjen e procesit se si është transformuar peizazhi.

FJALA PEIZAZH NË GJUHËN SHQIPE

Fjala peizazh është pjesë e fjalorit të zakonshëm të mjaft njerëzve me kualifikime nga më të ndryshmet. Kjo duket një fjalë jo shumë e ndërlikuar e cila i referohet diçkaje që ne mendojmë se e kuptojmë, por në fakt nëse ndalemi pak dhe bëjmë një analizë të thjeshtë mund të konstatojmë që ajo mbart aspekte të dallueshme për secilin prej nesh. Megjithëse fjala peizazh përdoret gjerësisht në gjuhën shqipe, ajo është një fjalë relativisht e re dhe me prejardhje nga gjuhët latine. Nuk është shumë e qartë se kur dhe si hyri kjo fjalë për herë të parë në gjuhën tonë, por bazuar në një analizë të thjeshtë të disa fakteve dhe rrethanave historike mund të supozohen një sërë mundësish midis të cilave janë edhe këto:

1. Në shekullin e XIX-të dhe fillimet e shekullit të XX-të mund të konstatohet një proces i njohjes dhe i rizbulimit të Ballkanit nga disa vende Europiane. Në këtë periudhë dokumentohen një sërë udhëtimesh të studiuesve, piktorëve, diplomatëve apo turistëve kulturorë europianë në territoret shqipfolëse. Midis tyre mund të veçohen oficeri anglez i zbulimit William Martin Leake (1805), Lordi Byron (1806), piktori i peizazhit Edward Lear (1848), diplomati francez Auguste Dozon (1875) etj. Mund të vlerësohet që Edward Lear nëpërmjet pikturave të peizazhit hodhi bazat e atij që mund të quhet udhëtimi artistik i europianëve në Shqipëri. Kjo është periudha kur piktura e peizazhit kishte njohur një ringjallje në Europë dhe piktorët e peizazhit ishin orientuar më shumë në njohjen dhe evidentimin e bukurive natyrore dhe të jetës së përditshme. Udhëtarët anglezë, për të komunikuar në territoret e perandorisë osmane përgjithësisht përdornin gjuhën frenge, italiane ose latine pasi anglishtja ishte shumë më pak e njohur. Kështu p.sh Edward Lear në ditarin e tij të udhëtimeve në Shqipëri dëshmon që shoqëruesi i tij e ndihmonte atë me përkthime nëpërmjet gjuhës italiane të cilën Lear e njohte, pasi për rreth 10 vjet kishte jetuar në Itali.

2. Dihet që në Itali prej shekujsh ka jetuar një komunitet arbëresh i cili asnjëherë nuk i

shkëputi lidhjet me vendlindjen. Prej këtij komuniteti ka një sërë personalitetesh me rol të rëndësishëm në procesin e rilindjes tonë kombëtare. Kurse sidomos pjesa veriperëndimore e Shqipërisë, kryesisht popullsia e besimit katolik, ka patur vazhdimisht praninë dhe ndikimin kulturor venecian. Si rezultat, sipas Indro Montanellit në publikimin e tij “Albania una e mille” (f. 98), ndikimi i guhës italiane në Shqipërinë e fillimit të shekullit të XX-të ishte i lartë.

Në vitin 1856 në Shkodër u themelua Foto Studio “Marubi” nga piktori, skulptori dhe arkitekti italian, Pietro Marubi. Lidhur ngushtë me familjen Marubi ishte fotografi dhe piktori Kolë Idromeno (1860-1939). Kolë Idromeno konsiderohet piktori i parë i peizazhit në Shqipëri. Në vitin 1875 ai kreu studime në Akademinë e arteve të bukura të Venecias dhe kuptohet që me kthimin në Shqipëri ai bëhet një nga promovuesit jo vetëm të fjalës, por edhe të artit të pikturës së peizazhit. Brezi i tretë i fotografëve Marubi, Gegë Marubi (1907-1984), studioi në Lion të Francës në vitet 1923-1927, pranë shkollës së parë të fotografisë dhe të kinemasë të themeluar nga vëllezërit Lymier. Gegë Marubi ishte mjeshtër i fotografisë së peizazhit me infra të kuqe duke u bërë i pari që përdori këtë proces të zhvillimit të fotografisë, pasi e mësoi atë Francë.

3. Piktori i famshëm i peizazhit, Vangjush Mio, i kreu studimet në fushën e artit në Itali dhe ka shërbyer si mësues arti në liceun francez të Korçës. Mio e njëjtte fjalën peizazh si nga italishtja ashtu edhe nga frengjishtja. Ai ndofta është i pari autor shqiptar që e ka shkruar fjalën peizazh si titull në pikturat e tij. Kështu kemi një pikturë të vitit 1919 dhe një të vitit 1933 të titulluara thjesht “Peizazh” si dhe disa piktura të tjera të titulluara “Peizazh fshati”, 1933, “Peizazh me përrua”, 1941 etj.

4. Në fund të shekullit të XIX-të fjala peizazh është huazuar nga frengjishtja edhe në gjuhën turke kështu që, një mundësi tjetër e ardhjes në gjuhën shqipe duhet konsideruar edhe nëpërmjet të shkolluarve në shkollat dhe universitetet e perandorisë osmane në fund të shekullit të XIX-të dhe fillimin e shekullit të XX-të.

5. Sidoqoftë në periudhën midis dy luftërave botërore fjala peizazh ishte e pranishme në gjuhën e shkruar shqipe edhe për faktin se një numër i konsiderueshëm të rinjsh kryen studime universitare në Itali dhe në Francë. Kështu kjo fjalë hyri në gjuhën tonë kryesisht si një term i pikturës dhe i gjeografisë.

6. Në vitin 1937, arkitekti italian i peizazhit Pietro Porcinai përgatiti propozimet e tij për projektin e peizazhit për pallatin mbretëror në Tiranë (Giusti, 2012). Pietro Porcinai mund të konsiderohet arkitekti i parë i peizazhit që ka vizituar Shqipërinë dhe ky projekt shënon një ngjarje të rëndësishme për arkitekturën e peizazhit në vendin tonë. Fatkeqësisht kjo ngjarje e rëndësishme nuk pati vazhdimësi në vitet pas Luftës së Dytë Botërore pasi regjimi komunist i ndërpreu lidhjet arsimore me botën perëndimore dhe specialistët e kopshteve dhe parqeve që përgatiteshin në shkollat e lindjes emërtoheshin inxhinierë gjelbërimi. Kështu, fjala peizazh në gjuhën shqipe deri vonë, mbeti një term kryesisht i piktorëve, gjeografëve dhe i shkrimtarëve.

Nga kërkimet e bëra prej autorit të këtij shkrimi, në publikimet periodike në gjuhën shqipe për herë të parë fjala peizazh është gjetur në një shkrim të gazetës “Tomorri”, 10 Mars 1940. Në këtë shkrim, kushtuar vizitës së një piktori italian në Shqipëri, përdoret fjala “të paesazheve”. Pas Luftës së Dytë Botërore, fjala fillon të përdoret në shtypin periodik vetëm në vitet 1960’, shpesh herë për të përshkruar ndryshimet e mëdha që ndodhën në territorin e vendit si rezultat i përpjekjeve të sistemit komunist për industrializimin e vendit dhe për kolektivizimin e bujqësisë. Në këtë periudhë, kryesisht në gazetën “Drita” dhe në revistën “Ylli”, gjejmë disa variante shkrimi të fjalës si: “pejsazh”, “pejzazh” dhe “peizazh”. Është

interesant fakti që shprehjet i referohen kryesisht ndryshimeve të thella që ndodhnin në atë kohë në të gjithë territorin e vendit. Kështu p.sh gjejmë shprehjet: “peizazh i ri”, “peizazh industrial”, “peizazh arkitektural”, “peizazh i fshatit” etj.

Gjithsesi, fjala “peizazh” për herë të parë përfshihet në fjalorin zyrtar të gjuhës shqipe në vitin 1980. Sipas këtij fjalori, fjala “peizazh” përcaktohet:

peizázh,-i emër i gjinisë mashkullore; numri shumës; -e(t):

- pamje e natyrës a e një vendi që rroket nga syri;
- art. vizatim a pikturë që paraqet një pamje të tillë: peizazh vjeshte; sodit peizazhin;
- term në letërsi; përshkrim i natyrës në një vepër letrare: mjeshër i peizazhit.

Siç mund të shikohet në këtë përcaktim nuk gjejmë pasqyrim kuptimet lidhur me transformimin e territorit, të cilat në fakt ishin bërë të zakonshme në shtypin periodik letrar të viteve 1960’ dhe 1970’. Theksimi i tepruar i natyrës në këtë përcaktim dhe fakti që për shumë kohë peizazhi ka qenë një term kryesisht i piktorëve, gjeografëve, shkrimtarëve apo edhe i atyre që merren me mjedisin ka bërë që termi të marrë më shumë nga çfarë duhet, kuptime që lidhen me natyrën dhe estetikën.

Pas miratimit të Konventës europiane të peizazhit (Firence 2000) dhe zgjerimit të studimeve universitare në arkitekturë peizazhi në Universitetin Bujqësor të Tiranës, peizazhi është gjithnjë e më shumë një zonë me interes akademik për një gamë të gjerë disiplinash, interes që është rritur më tej nga miratimi i ligjit për aderimin e Shqipërisë në Konventën Europiane të peizazhit në vitin 2016 dhe nga ndërgjegjësimi në rritje i publikut për rëndësinë e mjedisit në përgjithësi dhe të hapësirave publike në veçanti.

Për fat të keq, megjithëse Konventa Europiane e peizazhit jep një përkufizim të thjeshtë dhe të qartë për peizazhin “si pjesë territori, ashtu siç perceptohet nga njerëzit...” kjo gjë nuk ka gjetur ndonjë reflektim në përcaktimet e fjalës në fjalorët e mëvonshëm. Përkundrazi, ky mbivlerësim i pasaktë i natyrës në kuptimin e peizazhit shkon më tej në botimin “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” (2017) me autor Kolec Topalli, ku fjala peizazh përcaktohet shkurt dhe thjeshtë:

“PEIZÁZH m. “pamje e natyrës”. Huazim i ri nga fr. paysage, prej pays "vend" me prapashitesën -age.

KONCEPTI I PEIZAZHIT DHE PROFESIONI I ARKITEKTIT TË PEIZAZHIT

Problemi i peizazhit vjen në mijëra mënyra e aspekte dhe me një diversitet të madh në bisedat e zakonshme të njerëzve të ndryshëm. Kjo është një fushë e jashtëzakonshme e cila fsheh në shpirtin e secilit prej nesh diçka të veçantë, interesante, argëtuese dhe gjithmonë magjepsë. Ka një literaturë të gjerë që na vë përpara pjesën vizuale, të pamjes, të estetikës, të të bukurës me atë që është peizazhi si një koncept akademik apo shkencor. Peizazhi mund të kuptohet si një mënyrë për të parë botën dhe për të përfutur nga fuqia e pamjeve nga këndvështrime të ndryshme, për të kuptuar se si funksionojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet; ai është një mënyrë e të qenit të kësaj bote që nënkupton jo vetëm rolin e njerëzve, por edhe të gjallesave të tjera që janë apo kanë qenë në ato peizazhe.

Përcaktimi i Konventës Europiane të Peizazhit që, peizazhi është “një zonë, siç perceptohet nga njerëzit . . .” nënkupton që pak a shumë të gjithë duhet të angazhohemi në leximin dhe kuptimin e peizazhit. Pa perceptim nuk ka peizazh, kurse leximi është një hap më tej se perceptimi i thjeshtë. Pjesa tjetër e përkufizimit të Konventës së Peizazhit “... karakteri i të cilit është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë” shpjegon edhe faktin që disiplinat që përfaqësojnë peizazhin në emrat e tyre janë të shumta

dhe përfshijnë nga shkencat humane deri tek shkencat natyrore. Po t'i shikojmë më nga afër këto fusha, mund të konstatohet që fusha akademike të tilla si arkeologjia e peizazhit, ekologjia e peizazhit e deri tek urbanistika e peizazhit, përfaqësojnë specializime brenda një disipline më të gjerë dhe secila disipline priret të ketë një mënyrë të veçantë se si e shikon peizazhin. Por ndryshe nga disipinat e tjera, arkitektura e peizazhit ka një status unik pasi, ajo është e vetmja disipline në të cilën peizazhi nuk është një specializim apo qasje studimore, por është vetë thelbi i disiplinës.

Dy shekuj më parë, zhvillimi ekonomik, rritja e popullsisë, ndryshimet politike dhe sociale dhe intensifikimi i zonave të banuara nxorën në pah nevojën për kompetenca profesionale të cilat nuk mund të siguroheshin as nga arkitektët dhe as nga kopshtarët. Kështu, në shekullin e XIX-të lindi profesioni i arkitektit të peizazhit i cili do të luante një rol të rëndësishëm në hapësirën publike, sidomos në SHBA dhe në Europën Veriperëndimore. Megjithatë, gjatë shekullit të XX-të, arkitektët e ruajtën ndikimin e tyre mbizotërues edhe në hapësirën publike. Nën drejtimin e tyre, u projektuan qytete të cilat duhej të siguronin lëvizjen e mirë të makinave, por në të vërtetë, si rezultat ne morëm qytete të cilat periodikisht bllokohen nga trafiku. U projektuan qytete të cilat duhej ta largonin ujën e stuhive dhe morëm qytete të cilat vuajnë nga mungesa e ujit (por që herë pas here edhe përmbyten). Për të mos përmendur problemet me ndotjen e ajrit, ishujt e nxehtësisë apo ndryshimet klimatike. Të gjitha këto zhvillime kërkojnë një ridimensionim të rolit të arkitektëve të peizazhit dhe i ftojnë ata për një kontribut më të madh në zhvillimet e shekullit të XXI-të.

Shqipëria ka qenë relativisht e vonuar në këto zhvillime. Në vitet '80-'90' të shekullit të XX-të me futjen e ekologjisë në universitete, peizazhi u bë edhe një term i ekologëve. Megjithatë ishte ndoshta, ndikimi i fortë i shkencave mjedisore në këtë periudhë, sidomos në Universitetin Bujqësor të Tiranës, që bëri që lënda për kopshtet e parqet në departamentin e hortikulturës të quhej për një periudhë kohe gabimisht, "Arkitekturë mjedisi" dhe vetëm në vitin 2010 ajo mori emrin e saktë "Arkitekturë peizazhi". Kurse vitin e kaluar u diplomuan arkitektët e parë të peizazhit të cilët kanë kryer një cikël të plotë 5 vjeçar studimesh në arkitekturë peizazhi. Arkitektët e rinj të peizazhit kanë nevojë për mbështetje, por mbi të gjitha, kanë nevojë për një perceptim dhe kuptim të drejtë të rolit të tyre në sfidat që kalon vendi.

Arkitektët e peizazhit kanë përgjegjësinë e rëndësishme që të kuptojnë gjeneratat e kaluara, po ashtu si brezin e ri. Kjo i ndihmon ata që t'u përgjigjen pyetjeve të tilla si: Pse ne jetojmë në këtë mënyrë? Pse jemi këta që jemi dhe si kemi ardhur deri në këtë mënyrë jetese? Çfarë zgjedhesh po bëjmë tani dhe si mundet që e kaluara të na ndihmojë për të mbështetur mënyrën tonë të jetesës? A kemi arritur ne të kuptojmë, të prezantojmë dhe të përfshijmë në realitetin e gjallë të njerëzve, vendet që janë të dashura për ta dhe ato që janë të rëndësishme për gjallesat e tjera? Përgjigjet e këtyre pyetjeve na ndihmojnë të gjithëve që të arrijmë ta kuptojmë më mirë botën.

Nga diskutimet e mësipërme mund të kuptohet që peizazhi është i lidhur, por jo identik me natyrën. Natyra është pjesë e çdo peizazhi, por nuk është më shumë se një pjesë e tij e cila ka pësuar ndikimin e njeriut. Në këtë pikëpamje, peizazhi është gjithnjë përfshirës i njeriut dhe i natyrës, dhe jo një mënyrë për të dalluar, ose për të theksuar natyrën, siç krijohet përshtypja nga përcaktimet që gjejmë në fjalorët e ndryshëm të gjuhës shqipe. Në të vërtetë, ideja e peizazhit bie ndesh me njohjen e marrëdhënieve të thjeshta midis njeriut dhe natyrës. Përkundrazi, peizazhi fillon me pranimin e ndërthurjes së ndërlikuar intime të veçorive fizike, biologjike dhe kulturore, të cilat i shohim në çdo vështrim që mund të hedhim përreth nesh. Sipas D.W. Meing, peizazhi është, para së gjithash, uniteti që ne shohim, përshtypjet e shqisave tona, dhe jo logjika e shkencave.

Arkitektura e peizazhit është një profesion i cili ka marrë përsipër të kujdeset për planetin Tokë. (Murphy, 2016) Kjo do të thotë që arkitektët e peizazhit janë në grupin e atyre profesioneve që mund të marrin barrën e ndjekjes dhe të kujdesit për vendin tonë. Duke u bërë përgjegjës për Tokën, për oborrin, për lagjen, për fshatin apo për qytetin, arkitektët e peizazhit duhet të pranojnë edhe pasojat morale të kësaj përgjegjësie. Duke u kujdesur për planetin dhe krijesat e tij, arkitektët e peizazhit kujdesen për të gjithë ne, pasi ndjekja e natyrës me respekt dhe dashuri do të thotë të kujdesemi edhe për veten tonë.

Një profesion i ri si ai i arkitektit të peizazhit, përpara se të ketë përkrahjen e politikëbërësve, ka nevojë për mirëkuptimin dhe përkrahjen e medias dhe të shoqërisë. Pavarësisht sukseseve të arritura gjatë dekadës së fundit dhe sensibilizimit në rritje për nevojën e kopshteve, parqeve dhe të gjelbërimit, duhet pranuar që publiku i gjërë, politikanët dhe media nuk e kanë akoma nivelin e duhur të kuptimit mbi profesionin e arkitektit të peizazhit dhe për rolin e rëndësishmëm që ky profesion pritet të luajë në shumë aspekte të jetës dhe veprimtarisë së vendit tonë. Një pjesë e mirë e opinionit të gjerë publik e shikon këtë profesion më shumë si një profesion për zbulimin e mjedisit se sa një profesion që kujdeset për cilësinë e jetës dhe të mjedisit ku ne jetojmë. Kjo situatë është dëshmi se si përcaktimi jo i saktë i një fjale të vetme mund të ndikojë në të gjithë perceptimin publik për profesionin që lidhet me atë fjalë. Prandaj për ta përmirësuar këtë situatë dhe për t'u dhënë arkitektëve të peizazhit vendin që u takon, një nga punët e rëndësishme që duhet bërë është që specialistët e gjuhës shqipe të rishikojnë përcaktimin e fjalës peizazh në fjalorët e gjuhës.

Literatura

1. Clark K. (1949) *Landscape into Art*. Beacon Press, Boston. 280 p.
2. Cosgrove D. Daniels S. (1989). *The Iconography of Landscape: Essays on the Symbolic Representation, Design and Use of Past Environments*. Cambridge University Press. 330 pages
3. Furetière A (1690) *Dictionnaire universel*. Source: gallica.bnf.fr / Bibliothèque nationale de France.
4. Giusti, M. A. (2012) ‘‘Villa Reale’’ di Tirana: architetture, giardini, arredi, opere d’arte, dai progetti del ventennio al progetto di restauro’, in *Architetti e Ingegneri Italiani in Albania*. A cura di Ezio Godoli e Ulisse Tramonti. Edifir Edizioni Firenze s.r.l., pp. 137-143.
5. Hartshorne H. (1939). *The Nature of Geography and Perspective on the Nature of Geography*. In: *American Geography and Geographers: Toward Geographical Science*, <https://doi.org/10.1093/acprof:oso/9780195336023.001.0001>, accessed 4 Jan. 2024
6. Jackson, B. J (1984) *Discovering the Vernacular Landscape*. Yale University Press. USA. 188p
7. Meinig D.M (Editor) (1994) *The Interpretation of Ordinary Landscapes: Geographical Essays*. Oxford University Press, USA. 272 p.
8. Montanelli I. (2005) Shqipëria një dhe njëmijë. Shtëpia Botuese 55. Tiranë, 160 faqe
9. Motloch, J (2001) *Introduction to Landscape Design*, 2nd Edition John Wiley & Sons, - 384 pages
10. Murphy M (2016) *Landscape Architecture Theory*, Washington, Island Press.
11. Sauer C (1925) *The Morphology of Landscape*. Në: *Land and Life: A Selection from the Writings of Carl Ortwin Sauer*, edited by John Leighly, Berkeley: University of California Press, 1963, pp. 315-350.